



TV BALLKAN
Adelina SFISHTA
Drejtoreshë
Prizren

Ankesa Nr. 2017/27 KPM vs TV BALLKAN
Ref:1708/786/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2017/27 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër TV BALLKAN (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur më Licencë të KPM-së me datën 30 tetor 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, me datën 10 maj 2017, KPM ka realizuar monitorim në terren dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka ndërprerë transmetimin në rrjetin e tij tokësor.
3. KPM në bazë të të gjeturave nga raporti i monitorimit i datës 12 maj 2017, i ka dërguar Njoftim për Shkelje Palës Përgjegjëse duke kërkuar që menjëherë të fillojë me transmetim tokësor për çka edhe është licencuar nga KPM.
4. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, me datën 12 korrik 2017 ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje, ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, duke mos transmetuar në rrjetin tokësor. Në bazë të raportit të monitorimit është konstatuar se Pala Përgjegjëse vazhdon me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, ndërsa vazhdon të mos transmetojë në rrjetin tokësor për të cilën është licencuar nga KPM-ja.

Analiza Ligjore

5. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse, ka bërë shkelje të nenit 12 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Neni 12 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës përcakton se:

“Ndërprerjet e shpeshta dhe të zgjatura të transmetimit nga i Licencuari, do të shërbejnë si bazë që KPM të rishikojë rrethanat që mund të çojnë deri në anulimin e Licencës.”

6. KPM duke u bazuar në raportin e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 12 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, duke e ndërprerë transmetimin e sinjalit përmes rrjetit tokësor pa e njoftuar KPM-në për një veprim të tillë. Bazuar në nenin 12 të Kushteve të Licencës ndërprerjet e shpeshta të zgjatura dhe të paarsyeshme të transmetimit mund të rezultojnë edhe me ndërprerjen e licencës së transmetimit.
7. Pala Përgjegjëse ka bërë transmetimin e programit të vet vetëm përmes operatorëve të shpërndarjes dhe me këtë veprim i ka pamundësuar publikut, i cili mund të pranojë sinjalin e Palës Përgjegjëse vetëm përmes transmetimit tokësor, qasjen në informim. Pala përgjegjëse është e licencuar si ofrues i shërbimit medial audiovizual me transmetim tokësor e jo për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes.
8. KPM ka gjetur se edhe përkundër Njoftimit për shkelje Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 12 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, duke mos filluar me transmetim në rrjetin tokësor.

Vendimi

9. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 12 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
10. KPM, kërkon nga Pala Përgjegjëse që menjëherë të fillojë me transmetim në rrjetin tokësor në të kundërtën, KPM bazuar në nenin 30, paragrafi 1.6 i Ligjit të KPM-së, do t'ia ndërpresë licencën e transmetimit Palës Përgjegjëse.
11. Komisioni, bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 12 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

E drejta për Ankesë

12. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
13. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërishit relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar



10.08.2017
Datë